

KLSH merr pjesë në trajnimin e II “Krijimi i mbikëqyrjes gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni Veriore”: Dinamika brenda vendeve dhe sfidat rajonale.

Takimi u zhvillua në Ohër në datat 21-23 shtator 2022. Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë aktivitet u përfaqësua nga znj. Boriane Nikolla me detyrë Drejtor Departamenti Juridik dhe z. Koço Sokoli me detyrë Kryeauditues në Departamentin Juridik.

Trajnimi u organizua nga: Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë (CESS), Holandë; Instituti për Studime Politike (ISP), Shqipëri; Instituti Kosovar për Hulumtime të Politikave dhe Zhvillim (KIPRED), Kosovë; dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS), Maqedoni Veriore.



Tema e këtij kursi trajnimi ishte “Krijimi i mbikëqyrjes gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni Veriore”: Dinamika brenda vendeve dhe sfidat rajonale (II). Gjatë këtij trajnimi u punua në mënyrë interaktive lidhur me ndërlidhjen dhe dallimet ndërmjet reformës së sektorit të sigurisë (RSS), reformën e sistemit të sigurisë dhe qeverisjen (RSS-Q) si dhe rolet që parlamentet dhe aktorët e tjerë të mbikëqyrjes mund të luajnë në iniciimin dhe mbikëqyrjen e proceseve të RSS-Q-ës.

Trajnimi kishte si qëllim për të kuptuar se përse çështjet gjinore janë të rëndësishme, posaçërisht në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë duke diskutuar dhe kuptuar zbatueshmërinë dhe sfidat e krijimit të mekanizmave për barazi gjinore në sektorin e sigurisë në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë Veriore.

Gjithashtu, në trajnim u diskutua dinamika e tregtisë së paligjshme, çka paraqet ajo për sigurinë kombëtare dhe cilat janë sfidat për aktorët mbikëqyrës, si dhe lufta kundër kësaj tregtie të paligjshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë Veriore, duke identifikuar opsionet për një bashkëpunim të mëtejshëm rajonal.

Të gjitha sesionet u zhvilluan në mënyrë interaktive me ushtrime (të ndara) dhe në hapësirë të mjaftueshme kohore për debate dhe diskutime.